



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1193/11 Prot.

Elbasan më 5/11. 2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZH**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.91 datë 28.10.2025 “Për miratim shtesë punonjësish në Stacionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**



1183  
21.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHDI  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.30.10.2025

Nr. 1371 prot

Nr.91 dt.28.10.2025

**PËR MIRATIM SHITESË PUNONJËSISH NË STACIONIN E SHËRBIMIT TË  
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “Kreu i IX neni 54 gërma, në Shkresën me Nr.Prot. 3588/2 datë 29.04.2024 të Drejtorisë së Përgjithëshme të MZSH –së, “Për konfirmimin e shtesës së numrit të punonjësve të MZSH – së Librazhd“, në Aktin Normativ Nr.10 datë 08.10.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025“ të ndryshuar “Këshilli Bashkiak Librazhd i mbledhur sot në datën 28.10.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

**VENDOSI:**

1. Në Stacionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të shtohen edhe 6 (gjashtë) punonjës të tjerë të nivelit bazë.
2. Numri total i punonjësve të Sektorit të MZSH –së të jetë 22 punonjës.
3. Numri total i punonjësve të Bashkisë të jetë 456.
4. Efektet financiare për pagat dhe sigurimet shoqërore do të përballohen nga fondet e Ministrisë së Financave.
5. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale.
6. Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT  
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT  
Mitat BIÇAKU

